




INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM

Marrëdhëniet Polici-Media



- KOMUNIKIMI PUBLIK I POLICISË — THEMELTAR PËR PARANDALIMIN E KRIMIT
- DETYRAT FUNKSIONALE TË OFICERËVE TË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN NË D P Q
- REKOMANDIMET E VARNËS PËR MARRËDHËNIET POLICI — MEDIA
- 5 KËSHILLA TË RËNDËSISHME: SI TË PËRMIRËSOJMË DHE FORCOJMË MARRËDHËNIET POLICI — MEDIA
- E- GOVERNMENT NË DREJTORITË E VENDORE TË POLICISË
- INTERNETI — NJË MUNDËSI MË TEPËR PËR T'U SHFRYTËZUAR
- FEDERATA NDËRKOMBËTARE E GAZETARËVE - DEKLARATA E PARIMEVE TË SJELLJES
- DREJTIMET KRYESORE TË PUNËS SË SPECIALISTIT TË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN PRANË D P Q



Mbështetur nga Soros

Komunikimi publik i policisë – themeltar për parandalimin e krimit

Raportet e komunikimit publik të policisë mbeten në themel të përpjekjeve për hapjen e Policisë së Shtetit, forcimit të bashkëpunimit të policisë me komunitetin, forcimit të besimit të publikut tek policia dhe bashkërendimit të përpjekjeve për forcimin e komponentit parandalues të krimit. Raportet egzekutiv-media kanë patur dhe kanë një specifikë të veçantë dhe dëshmojnë në një plan të përgjithshëm konceptin qeverisës në lidhje me transparencën, përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe postin zyrtar si shërbim publik. Ndërsa, raportet polici-media kanë një rëndësi edhe më të madhe duke u lidhur drejtpërsëdrejti me përmirësimin e shërbimeve të sigurisë ndaj qytetarit në bashkëpunim të ngushtë me të.

Koncepti i marrëdhënieve me publikun në polici merr një rëndësi të madhe në kushtet kur policia po përqafohet policimin në komunitet dhe parandalimin e krimit si detyra parësore të sigurisë publike.

Pavarësisht, statusit të miratimit të Strategjisë së Policimit në Komunitet si filozofi policimi dhe plan veprimi e organizimi të Policisë së Shtetit, sukcesi i implementimit të saj do të varet shumë edhe nga komponenti publik i kësaj strategjie. Pra, policimi në komunitet mbetet një detyrim institucional i Policisë së Shtetit, por që zbatimimi i saj, apo me saktë sukcesi i saj si praktikë policimi kërkon medoemos partneritetin me komunitetin apo qytetarët. Por, që të sigurohet një qëndrim aktiv i komunitetit në policim

dhe bashkëpunim me policinë, strategjia qëndrore apo vendore e strukturave të policisë duhet të njihet nga qytetarët. Pra, komuniteti duhet të informohet në mënyrë intensive se çka kërkon policia nga qytetarët për përmirësimin e sigurisë publike. Pikërisht, krahas detyrimeve të tjera funksionale, një drejtim gjithmonë në rritje të punës së specialistëve të marrëdhënieve me publikun në drejtoritë e policisë së qarqeve dhe ekspertëve të tjerë të policisë në nivel qëndror e vendor mbetet komunikimi i gjerë publik ku policia të shfaqet në nëpërmjet medias jo vetëm në zbatim të ligjit për të luftuar krimin, por si një shërbim shumë më i gjerë publik në interes të drejtëpërdrejtë të sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve.

Në kushtet aktuale kur Policia e Shtetit gjithmonë e më shumë po gjen vetveten në një filozofi perëndimore policimi, marrëdhëniet me publikun kapin një rëndësi gjithmonë e më të madhe. Polica duhet të prezantojë sa më gjerësisht në publik praktikën e policimit në komunitet.

Falë mbështetjes së Fondacionit SOROS për dy vjet me radhë janë realizuar një sërë aktivitetesh trainuese qendore dhe sensibilizuese vendore në shumë rrethe të vendit për rolin, detyrat dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të marrëdhënieve me publikun. Rëndësi parësore në këto aktivitete ka zënë sensibilizimi i drejtuesve vendorë dhe qëndrorë të Policisë së Shtetit për të përmirësuar infrastrukturën fizike dhe



ligjore të zyrave të marrëdhënieve me publikun.

Pas diskutimesh me ekspertë në nivele të ndryshme me Urdhër No 2122 të Ministrisë të Rendit Publik, datë 12.6 2005 u bë i mundur miratimi i “Detyrave Funktionale të Oficerëve të Marrëdhënieve me Publikun në Drejtoritë e Qarqeve, përzgjedhja, varësia, buxheti, organizimi dhe bashkëpunimi”. Ky akt normativ i realizuar për herë të parë merr rëndësi parësore sepse



mirëpozicionon zyrat e marrëdhënieve me publikun për të bashkëpunuar me sektorët e tjerë të policisë për të rritur volumin e informacionin publik. Mbështetur në këtë akt normativ, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim ka realizuar një sërë tyreash vendore me drejtues kryesorë të strukturave vendore të policisë me synim harmonizimin e kërkesave të këtij Urdhëri për një punë sa më efektive, cilësore dhe profesionale të zyrave të marrëdhënieve me publikun në nivel vendor. Ndërkohë, fondacioni i shoqërisë së hapur “SOROS” ka mbështetur me teknologji të informacionit 10 zyra të marrëdhënieve me publikun në Drejtoritë e Policisë së Qarqeve Shkodër,

Kukës, Lezhë, Durrës, Tiranë, Korçë, Berat, Vlorë e tjera si dhe botime të ndryshme, përfshirë Kodin e Etikës së Policisë.

Gjatë dy vjetëve të fundit, komunikimi me median e Policisë së Shtetit ka pësuar përmirësime të ndjeshme, në mënyrë të veçantë në iniciativën e policisë në qendër dhe në bazë për të informuar publikun edhe gjatë proceseve elektorale. Shume problematika vendore janë zgjidhur nëpërmjet një komunikimi të shpejtë dhe

profesional, duke ruajtur integritetin e institucionit të Policisë së Shtetit në zbatim të ligjit me paanshmëri dhe profesionalizëm. Gjithësesi, mbetet ende shumë për të bërë që nëpërmjet medias, komunikimit elektronik e formave nga më të larmishmet të komunikimit, Policia e Shtetit të sigurojë vendin e merituar në një shoqëri demokratike si shërbim publik në interes të qytetarëve dhe në bashkëpunim me ta.

*Shënim nga S. Hroni
Drejtor Ekzekutiv i IDN*

DETYRAT FUNKSIONALE TË OFICERËVE TË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN NË DREJTORITË E POLICISË NË QARQE

Të miratuara me urdhër të ministrit Nr. 2122 datë 22.6.2005

VIZIONI

Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun, mbështetur në eksperiencat më të mira evropërdimore, investohet maksimalisht në përmirësimin e imazhit të strukturave të Policisë së Shtetit në përmirësimin e vazhdueshëm të shkallës së njohjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut të këtyre strukturave nëpërmjet shfrytëzimit të burimeve të brendshme, bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe rritjes së shkallës së transparencës.

Detyrat kryesore të marrëdhënieve me publikun

- Informimi i publikut mbi aksionet, strukturat dhe reformat e policisë.
- Informimi i publikut mbi shkallën e kriminalitetit
- Promovimi i imazhit të policisë në publik dhe në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Mbrojtja e policisë kur ajo sulmohet publikisht.
- Informimi i brendshëm i policisë.
- Edukimi i policisë në fushën e të drejtave të njeriut dhe të etikës policore.
- Parandalimi i kriminalitetit me një veprim edukativ kundrejt popullatës.
- Punë sociale në përfitim të anëtarëve të policisë dhe të familjeve të tyre.
- Organizim i ceremonive zyrtare të policisë
- Ndërmjetësimi ndërmjet policisë dhe shoqërisë civile.

Parimet etike që duhen respektuar nga personeli që punon në marrëdhëniet me publikun.

- 4 Trajtim i barabartë i mediave të ndryshme cilido qoftë sensibiliteti i tyre politik
- 4 Mbrojtja e jetës private dhe e dinjitetit njerëzor.
- 4 Respektimi i prezumimit të pafajësisë dhe i sekretit të hetimeve.
- 4 Ndalimi i marrjes së çdo pozicioni politik publik
- 4 Refuzimi i çdo lloj korrupsioni.

Njohuritë, aftësitë dhe eksperiencia

Oficerët e policisë të punësuar në shërbimet e marrëdhënieve me publikun duhet të kenë cilësitë e mëposhtme:



Të njohin mirë strukturat e policisë

- Të kenë paraqitje të mirë dhe moral shembullor
- Të jenë të hapur dhe të aftë për të ndërmarrë iniciativa.
- Të jenë të komunikueshëm
- Të dinë të komunikojnë edhe në gjuhë të huaja

Për të rritur efektivitetin e këtij shërbimi, kohëzgjatja e punësimit të oficerëve duhet të jetë të paktën 2 vjet me mundësinë e zgjatjes së këtij afati. Përveç kësaj personeli i punësuar në marrëdhëniet me publikun nuk duhet të ketë funksione të tjera në polici.

Organizimi

Efektivi i zyrës së marrëdhënieve me publikun mund të përbëhet nga një ose më shumë punonjës. Në këto zyra mund të punësohen ata(o) që kanë përfunduar studimet e larta, Akademinë e Policisë apo kanë kryer studimet për Drejtësi Sociologji dhe Gazetari.

pozicioni organizativ

Zyra e marrëdhënieve me publikun varet direkt nga drejtori i Policisë të Qarkut. Ajo është e pavarur nga shërbimi i marrëdhënieve me publikun i Ministrisë së Rendit, me të cilin duhet megjithatë të punojë në bashkëpunim. Çdo oficer duhet të paraqesë çdo vit Drejtorit të Policisë të Qarkut bilancin e



veprimeve të tij, në funksion të këtij bilanci dhe të sugjerimeve të formuluar. Drejtori i Policisë të Qarkut harton objektivat e veçanta të zyrës në funksion me buxhetin e disponueshëm.

Buxheti dhe pajisjet

Çdo zyrë e marrëdhënieve me publikun duhet të ketë ambientet e veta. Këto ambiente duhet të jenë të treguara mirë dhe lehtësisht të arritshme dhe të kontaktueshme. Drejtori i Policisë të Qarkut i akordon një buxhet funksionimi vjetor zyrës së tij të marrëdhënieve me publikun. Në funksion të buxhetit dhe ndihmave që disponon nga jashtë, çdo zyrë duhet të jetë e pajisur me: një kompjuter me printer, një telefon, një faks, një aparat fotografik, një fotokopje dhe një diktofon.

Përgjegjësitë kryesore

Çdo zyrë e marrëdhënieve me publikun mbulon tri fusha:

- ✓ Marrëdhëniet e jashtme dhe ndërmjetësim
- ✓ Marrëdhëniet polici – media
- ✓ Marrëdhëniet polici – publik

Marrëdhëniet e brendshme dhe ndërmjetësimi

Zyra e marrëdhënieve me publikun qarkullon informacionin brenda prefekturës dhe kryen rolin e bashkëbiseduesit midis policisë së qarkut dhe civilëve apo policëve të pakënaqur me qëllim që të zgjidhen në maksimum me mirëkuptim problemet duke shmangur kështu rreziqet e konflikteve sociale dhe rreziqet e kritikave kundër policisë. Zyra e marrëdhënieve me publikun harton një buletin informimi të brendshëm të qarkut, për të informuar të gjithë personelin mbi aktivitetin e policisë, mbi evolucionin e kriminalitetit, ligjet e reja, si dhe për të rejat me karakter personal dhe social (punësime, lëvizje, dhe dekorime.) Përmbajtja dhe frekuenca e daljes së këtij bulletini informues përcaktohet nga ***Drejtori i Policisë të***

Qarkut.

Zyra e Marrëdhënieve me publikun pret qytetarët që kanë ankesa lundrejt policisë. Ai përgatit një dosje Drejtorit të Policisë të Qarkut i cili merr vendimin. Zyra e marrëdhënieve me publikun bashkëpunon me drejtorinë e marrëdhënieve me publikun në interes të realizimit në qark të programeve të edukimit dhe të formimit.

Marrëdhëniet Polici – Media

Zyra e marrëdhënieve me publikunm nëpërmjet kontakteve direkte me gazetarët investohet me qëllim krijimin e një klime bashkëpunimi të dyanshëm në interes të publikut dhe policisë. Pasi konsultohet me përgjegjësit e shërbimeve të ndryshme të policisë së prefekturës oficeri “marrëdhëniet polic media” informon gazetarët mbi ngjarjet e ditës. Ai u përgjigjet pyetjeve të tyre. Zyra e marrëdhënieve me publikun mund të kontaktojë me drejtorinë e marrëdhënieve me publikun në rast ngjarjesh të rëndësishme, ose kur kërkohet të bëhet një reportazh i veçantë.

Informacione paraprake

Zyra e marrëdhënieve me publikun me urdhër te drejtorit të policisë së prefekturës mund të informojë mediat ose Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun mbi një operacion të ardhshëm të policisë për të mbuluar atë direkt.

Informacione të përgjithshme

Zyra e Marrëdhënieve me Publikun informon mediat mbi realizimet e reja të policisë së qarkut, suksese të rëndësishme të policisë dhe evolucionin e kriminalitetit. Ai mund të bëjë që të botohen lajme për persona në kërkim, thirrje dëshmitarësh dhe kërkesa për informata për të ndihmuar policinë gjyqësore të prefekturës.

Informacionet në dëm te policisë

Zyra e Marrëdhënieve me Publikun përgënjeshton informacione të pasakta ne lidhje me poicinë e prefekturës të cilat janë botuar në media. Për të provuar që policia punon me transparencë dhe që ajo nuk qëndron mbi ligjet, Zyra e Marrëdhënieve me Publikun me autorizim të drejtorit të policisë se qarkut mund tu transmetojë mediave gabimet e kryera nga policia dhe sanksionet e marra. Në raste të tilla ai tenton të zbusë pasojat negative të këtyre gabimeve tek opinioni publik. Zyra e Marrëdhënieve me Publikun mbron policinë dhe punonjësit e policisë kur ata sulmohen nga mediat. Për të bërë një gjë të tillë ai bën të botohen përgënjeshtime, shpjegime ose te drejtën e përgjigjes së nevojshme.

Përmbledhja e shtypit

Zyra e Marrëdhënieve me Publikun përgatit me kërkesën e drejtorit të policisë së qarkut një përmbledhje të përditshme shtypi.

Intervista

Zyra e marrëdhënieve me Publikun përgatit intervistat, konferencat e shtypit dhe komunikatat e drejtorit të policisë së qarkut apo të drejtuesve të tjerë të policisë të ngarkuar prej tij.

Marrëdhëniet polici-publik (policimi në komunitet)

Zyra e Marrëdhënieve me Publikun mbi bazën e studimeve të gjendjes së kriminalitetit harton programe afat-shkurtëra, mesme apo afatgjata për parandalimin e kriminalitetit, të cilat miratohen nga Drejtori i Policisë së Qarkut.

Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe punonjës të tjerë të policisë sipas strukturave përkatëse, në bashkëpunim me OJF, organizma ndërkombëtare dhe trupin pedagogjik, organizojnë në shkolla takime e biseda parandaluese kundër kriminalitetit, drogës, prostitucionit, dhunës në familje, pasigurisë në rrugë etj.

Zyra e marrëdhënieve me Publikun në bashkëpunim me Median, OJF, organizma ndërkombëtare apo publiciteteve të prodhuar nga vetë policia sensibilizon popullsinë mbi dhunën urbane, kriminalitetin, dhunën në familje dhe mjetet për t'i parandaluar ato.

Organizimi i aktiviteteve

Zyra e marrëdhënieve me publikun në raste festash, ceremonish, përvjetorësh etj, hartojnë plane masash apo programe për organizimin dhe mbarëvajtjen e tyre.

DREJTIMET KRYESORE TË PUNËS SË SPECIALISTIT TË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN PRANË DREJTORISË SË POLICISË NË QARK

1. Përgatitja e buletineve mujore të DPQ-ve që do të paraqesin punën dhe problemet me të cilat përballet policia.

Qëllimi i këtyre buletineve do jetë transparenca dhe prezantimi sa më real i punës së policisë duke bërë të mundur që edhe komuniteti të njohë realisht punën efektive të policisë duke ndikuar kështu në përmirësimin e imazhit si dhe në rritjen e besimit publik.

2. Përgatitja periodike e njoftimeve për shtyp me karakter informativ dhe problemor.

Njoftimet e shtypit nuk duhet të kufizohen vetëm në paraqitjen dhe bërjen publike të ngjarjeve të veçanta që në pamje të parë tëheqin më tepër publikun dhe opinionin. Bërja publike e informacioneve si dhe trajtimi në

media i problemeve të ndryshme do të rrisë prezencën në media të punës parandaluese të policisë.

3. Informimi periodik (muajor) për shkallën e bashkëpunimit me komunitetin dhe ndëristitucional.

Me anë të këtyre informacioneve publiku krijon bindjen se policia reagon dhe ndjek të gjitha problemet që evidentohen në takimet me komunitetin si dhe bëhet ndarja e përgjegjësive përsa i përket kompetencave në zgjidhjen e problemeve të ndryshme.



4. Të paraqitet duke u bërë publike një herë në muaj statistika e sallës operative për të treguar shkallën e pjesëmarrjes së komunitetit në parandalimin e krimit dhe sigurimin e rendit dhe qetësisë.

Publikimi i këtyre statistikave do të tregojë seriozitetin e këtij shërbimi si dhe duke krijuar besim do të nxisë komunitetin për të qenë më aktiv dhe i përgjegjshëm në përpjekjet për luftën ndaj krimit dhe parandalimin e tij.

5. Sensibilizimi në vazhdimësi i sektorëve të tjerë të DPQ për rolin dhe rëndësinë e Zyrës së Marrdhënieve me Publikun.

Ky sensibilizim përveç të tjerash do të bëhet nëpërmjet prezantimit të efektshmërisë dhe rezultateve konkrete të punës së kësaj zyre.

*Përgatitur nga Specialistët e Marrdhënieve me Publikun pranë DPQ-ve
Tiranë më 10 – 11 Dhjetor 2005*



UDHËZIME DHE REKOMANDIME PËR MARRËDHËNIET POLICI – MEDIA¹

Bazuar në Nenin 10 Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (ECHR) që garanton të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informimit;

Bazuar gjithashtu në nenin 19 Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 19 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike që garantojnë të drejtën dhe lirinë e shprehjes dhe informimit;

Bazuar në nenin 14 të ECHR që ndalon diskriminimin për shkak të seksit, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit fetar, bindjeve politike ose të tjera, orgjinës kombëtare ose sociale, përkatësisë në një minoritet kombëtar, pronës, përkatësisë prindërore ose çfarëdo satatusi tjetër;

Bazuar në Deklaratën e Këshillit të Evropës për Policinë ... Kapitulli A, Etika;

Duke marrë parasysh gjithashtu edhe Kodin e Sjelljes për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit i cili në nenin 2 përcakton detyrimin për të respektuar dinjitetin dhe të drejtat e njeriut; Duke pranuar që në një shoqëri demokratike të gjitha organet e qeverisjes, duke përfshirë edhe policinë, kanë detyrimin për të informuar publikun rreth punës së tyre;

Duke pranuar se një shërbim policor transparent dhe i përgjegjshëm është një element thelbësor i transformimit demokratik të policisë nga një forcë në shërbim;

Duke pranuar se hapja dhe transparenca e policisë rrit besimin e publikut në punën e policisë duke ndihmuar në zbulimin dhe parandalimin e krimit;

Duke pranuar se e drejta për të kërkuar, marrë dhe shpërndarë informacion ushtrohet nga masmedia, rolin e medias në informimin e publikut për çështje të interesit publik si dhe rolin e saj si "Watchdog" i qeverisë;

Duke pranuar standartet etike dhe kodet e sjelljes të profesionit të gazetarisë janë çështje të profesionistëve të medias dhe jo të fushës së legjislacionit;

Udhëzimi 1: **Parimi i Hapjes**

Në dhënien e informacionit për publikun, parimi bazë për shërbimet policore, për departamentet e marrëdhënieve me publikun dhe veçanërisht për zëdhënësit e policisë duhet të jetë transparenca dhe hapja ndaj publikut.

- 1.1 Qëllimi i shërbimit për marrëdhëniet me publikun në polici do të jetë dhënia e informacionit të plotë dhe në kohë optimale për median dhe publikun, rreth të gjitha aspekteve të punës së policisë, kryesisht, por jo vetëm, informacione në lidhje me punën e policisë për zbulimin dhe parandalimin e krimit si dhe të ruajtjes së rendit publik.
- 1.2 Informacioni për median dhe për publikun duhet të përfshijë informacione rreth funksionimit të departamenteve të ndryshme të Ministrisë së Brendshme dhe

¹ Dokument i miratuar në Varna (Bullgari) në një Konferencë Ndërkombëtare të organizuar nga ABA – CEELI, në Maj.2002

Policisë si psh raporte financiare apo strukturat e menaxhimit.

- 1.3 Dhënia e informacionit duhe të bazohet në Legjislacionin për lirinë e informimit, rregulloret e brendshme, kode të ndryshme si dhe në kërkesa të tjera për hapjen ndaj publikut duke u interpretuar në bazë edhe të standarteve më të larta evropiane dhe ato ndërkombëtare.
- 1.4 Informacioni duhet t'u jepet mediave qoftë paraprakisht ashtu edhe me kërkesë të tyre. Dhënia paraprake e informacionit duhet të përfshijë njoftimet (komunikatat) për shtyp dhe konferencat e shtypit. Një zëdhënës i deleguar i policisë duhet të jetë i disponueshëm në çdo kohë për tu përgjigjur pyetjeve të medias dhe të ndihmojë duke dhënë informacione rreth punës së policisë.
- 1.5 Shërbimet e Marrëdhënieve me Publikun në Polici duhet të strukturohen në mënyrë të atillë që të lehtësojnë dhënien e informacioneve të plota dhe në kohë për mediat.

Udhëzimi 2: Mbi balancimin mes Interesit Publik dhe kufizimeve ligjore për informimin.

- 2.1 Kufizimet në informacionin që policia duhet t'i ofrojë publikut, duhet të jenë vetëm ato të parashikuara në ligjet ndërkombëtare duke përfshirë edhe çështje të sigurisë kombëtare, rendit publik si dhe mbrojtjes së të drejtave dhe reputacionit të të tjerëve. Në të gjitha rastet çdo kufizim duhet të vlerësohet me kujdes për t'u siguruar se është i parashikuar qartë në ligj dhe se plotëson kushtet për të qenë i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Në të gjitha rastet, çështjet e interesit publik duhet të qëndrojnë mbi ato të konfidencialitetit.
- 2.2 Legjislacioni i Lirisë së Informimit duhet të ketë gjithmonë përparësi ndaj ligjeve dhe rregulloreve qeveritare për klasifikimin e informacioneve në të cilat do të përfshihen ligje për sekretin shtetëror të cilat klasifikojnë informacionet mbi bazën e sigurisë kombëtare kode të ndryshme procedurale për ruajtjen e sekretit të hetimeve, ligje për mbrojtjen e të dhënave etj.
- 2.3 Në qoftë se një informacion nuk është klasifikuar qartë si konfidencial dhe oficeri i marrëdhënieve me publikun ose zëdhënësi e bën publik këtë informacion, atëherë ky person nuk duhet në asnjë mënyrë të mbajë përgjegjësi për shpërndarjen e atij informacioni.

Udhëzimi 3: Mbi të drejtën e medias për të kërkuar, marrë dhe shpërndarë informacionin.

Policia duhet t'u njohë të gjithë profesionistëve të medias të drejtën themelore për të kërkuar, marrë dhe shpërndarë unformacion.

- 3.1 Në ushtrimin e të drejtës themelore për të kërkuar, marrë dhe shpërndarë informacion, medias duhet t'i garantohet liria e marrjes së informacioneve që disponon policia

- dhe gjithashtu duhet t'i jepet e drejta e hyrjes në ambientet ku ajo (media) mund të grumbullojë informacion.
- 3.2 Oficerët e marrëdhënive me publikun duhet të pranojnë detyrimin profesional të gazetarëve për të verifikuar informacionin si dhe për të kërkuar burime të ndryshme informacioni. Kërkimi dhe publikimi i informacioneve të siguruar nga burime alternative që ndonjëherë mund të jenë edhe të kundërta me deklaratat zyrtare të policisë duhet të tolerohen dhe nuk duhet të përbëjnë shkak për diskriminim në të ardhmen për dhënien e informacioneve gazetarit ose medias në fjalë.
 - 3.3 Duke pasur parasysh se media ka një funksion të ndryshëm nga policia në shoqëri dhe se nuk u nënshtrohet detyrimeve dhe përgjegjësisë të njëjta, policia nuk duhet të tentojë të përdorë gazetarët si burime informacioni në hetime duke përjashtuar rastet kur informacioni botohet në media. Ky udhëzim nuk përjashton faktin që gazetarët shpesh mund të jenë vetë subjekte të një hetimi penal.
 - 3.4 E drejta e gazetarëve për të përdorur dhe mbrojtur burimet anonime të informacionit duhet të respektohet gjithmonë nga policia. (Shih rekomandimet e Këshillit të Evropës)
 - 3.5 Policia duhet të pranojë se puna e medias për vënien para përgjegjësive të organeve qeveritare do të përfshijë edhe analizimin dhe raportimin e punës së policisë gjë që shpesh mund të ekspozojë abuzim apo korrupsion brenda radhëve të policisë.

Udhëzimi 4: Mbi të Drejtat e Viktimave dhe Dëshmitarëve

Të drejtat e viktimave dhe të dëshmitarëve të krimeve të ndryshme duhet të respektohen nga policia në bërjen publike të informacioneve.

- 1.1 Policia duhet të respektojë konfidencialitetin (the privacy) e viktimave apo dëshmitarëve të një krimi në të gjitha komunikatat/deklaratat për shtyp.. Një mbrojtje e veçantë duhet t'u sigurohet viktimave të krimeve seksuale (përdhunim, dhunë në familje) dhe minoreneve. Konfidencialiteti mund të mos respektohet në rastet e çështjeve me interes publik si psh në rastet kur bëhet fjalë për një person publik (zyrtar).
- 1.2 Policia mund të lejojë që, nëpërmjet procedurave të veçanta, t'i jepet mundësia mediave të intervistojnë viktimat ose dëshmitarë në interes të zbulimit ose parandalimit të krimit duke luajtur rolin e ndërmjetësit në marrjen e aprovimit për një intervistë. Në asnjë rast policia nuk duhet të ushtrojë presion mbi viktimën apo dëshmitarin për t'a detyruar atë të flasë për mediat. Mediat nga ana e tyre duhet që t'i nënshtrohen këtij udhëzimi si një çështje e etikës profesionale.

Udhëzimi 5: Mbi Presumimin e Pafajësisë & të Drejtën për një proces gjyqësor të drejtë

E drejta për t'u prezumuar (konsideruar) i pafajshëm deri sa të provohet e kundërta si dhe e drejta për një proces gjyqësor të drejtë duhet të respektohet në çdo rrethanë. Këto të drejta duhet të pasqyrohen dhe të respektohen në çdo informacion që policia i jep mediave. Në rastet e çështjeve me interes publik, policia mund të japë informacion shtesë si emrat e të

dyshuarve të cilët mund të publikohen në rast se të dyshuarit janë zyrtarë ose personalitete të njohura. Megjithatë në çdo rast të drejtat e mësipërme duhet të respektohen në maksimumin e tyre.

Mediat gjithashtu duhet që t'i nënshtrohen këtij udhëzimi si një çështje e etikës profesionale

Udhëzimi 6: Parimi i Mosdiskriminimit

Informacioni i dhënë nga policia nuk duhet të përmbajë të dhëna diskriminuese mbi bazën e racës, përkatësisë në një grup etnik, kombësisë, ngjyrës, gjinisë, orientimeve seksuale, gjuhës, fesë, bindjeve fetare, politike apo të tjera, orgjinës kombëtare apo sociale, pronës, etj

- 6.1 Informacioni i policisë mund të përmendë të dhëna për racën ose cilësi të tjera të një personi të përfshirë në një vepër penale qoftë si i dyshuar qoftë apo si viktimë vetëm në rastet kur përbën një element të rëndësishëm të lidhur me natyrën e veprës penale dhe është në interes të parandalimit ose zbulimit të krimit.
- 2.2 Në prezantimin e statistikave duhet të tregohet kujdes për mosdiskriminimin mbi bazë të racës, përkatësisë në një grup etnik, kombësisë, ngjyrës, gjinisë, orientimit seksual, gjuhës, fesë, bindjeve fetare apo të tjera. Megjithatë, informacioni statistikor mund të përfshijë të dhëna lidhur me grupe të ndryshme shoqërore për sa kohë kjo bëhet në mënyrë jodiskriminuese dhe me qëllim përmbushjen e interesit të publikut për të pasur një informacion të plotë rreth punës së policisë.
- 2.3 Duhet të tregohet kujdes edhe për t'u siguruar që të mos ketë diskriminim në dhënien e informacionit mediave dhe publikut. Në mënyrë të veçantë policia nuk duhet të bëjë dallime mes mediave ose gazetarëve të ndryshëm dhe duhet të sigurohet që të gjithë qytetarët të kenë mundësi të barabarta për të marrë informacionet nga policia.

Udhëzimi 7: Mbi Informacionet për Parandalimin e Krimit

- 1.1 Policia duhet të jetë e hapur dhe proaktive në dhënien e informacioneve që mund të ndihmojnë në parandalimin dhe zbulimin e krimit. Informacione të kësaj natyre mund të bëhen publike si nëpërmjet medias ashtu edhe nëpërmjet fletëpalosjeve, broshurave, posterave etj.
- 7.2 Policia duhet të bashkëpunojë me mediat për publikimin e informacioneve të ndryshme që ndikojnë në parandalimin e krimit. Është një fakt i njohur që media luan një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e informacioneve që promovojnë ndjeshmërinë e publikut ndaj krimit dhe ndihmojnë në parandalimin e krimit. Media inkurajohet të shpërndajë dhe publikojë informacione të këtij karakteri edhe vullnetarisht.



Udhëzimi 8: Mbi mënyrën e trajtimit të akuzave ndaj policisë për abuzime dhe korrupsion

Policia duhet të sigurohet që publiku të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me akuzat për abuzim dhe korrupsion. Ku lloj informacioni duhet të trajtohet si çdo informacion tjetër që disponon policia. Në rastet kur dyshohet për kryerjen e një vepre penale ose kur ka filluar një ndjekje penale për një rast abuzimi ose korrupsioni ndaj një punonjësi policie, ky informacion duhet t'i prezantohet publikut njësoj si çdo informacion tjetër rreth një krimi ose procesi hetimor. Megjithatë mund të jetë në interes të publikut dhënia e informacioneve shtesë si emrat e oficerëve të policisë që ndodhen nën hetim në të njëjtën mënyrë si mund të publikohen emrat e zyrtarëve dhe personave të tjerë publikë në interes të ruajtjes së besimit publik në punën e policisë.

Rekomandime

Rekomandimi 1: Mbi Etikën Gazetareske

Rekomandohet që të gjithë gazetarët dhe kompanitë mediatike t'u përmbahen kodeve të sjelljes dhe etikës së gazetarisë profesionale. Standarte të tilla duhet të hartohen dhe të pranohen nga profesionistët e medias mbi baza të vetërregullimit në nivel individual nga secila medie ose nga shoqata dhe organizata të profesionistëve të medias. Standartet ndërkombëtare qartësojnë se është e papërshtatshme që etika gazetareske të rregullohet me ligj. Rekomandohet që, në mënyrë të veçantë, kodet e etikës gazetareske t'u përmbahen dhe të respektojnë udhëzimet 4,5 dhe 6 të kësaj deklaratë.

Rekomandimi 2: Mbi aprovimin e udhëzimeve të detajuara për punën e oficerëve të marrëdhënieve me publikun në polici

Rekomandohet që Ministrinë e Brendshme ose Policia të aprovojë udhëzime të hollësishme për punë e oficerëve të marrëdhënieve me publikun në kuadër të strukturave të policisë, udhëzime që mund të shtohen dhe qartësohen edhe në nivel vendor. Qëllimi i këtyre udhëzimeve dotë jetë lehtësimi i punës së zëdhënësit dhe oficerit të marrëdhënieve me publikun në ofrimin e informacioneve ndaj publikut.

Rekomandimi 3: Mbi trainimin e zëdhënësit dhe oficerëve të policisë

- 3.1 Rekomandohet që të gjithë zëdhënësit e policisë të trainohen rregullisht mbi standartet dhe procedurat e dhënies së informacionit ndaj mediave dhe publikut. Këto trainime duhet të përfshijnë instruktive mbi legjislacionin dhe si duhet balancuar interesi publik dhe liria e informimit me detyrimin ligjor për mospublikimin e informacioneve të klasifikuara.
- 2.2 Rekomandohet që Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Marrëdhënieve me publikun, shkollat e trainimit të policisë dhe Akademitë e Policisë të ofrojnë trainime specifike

për të gjithë oficerët e policisë mbi udhëzimet për dhënien e informacioneve. Punonjësit dhe oficerët e policisë duhet të kenë njohuri të qarta rreth llojit të informacionit (si dhe kur) që mund t'i jepet publikut si dhe të kuptojnë rolin e medias dhe mënyrën si duhen trajtuar gazetaret në situata të ndryshme.

Rekomandimi 4: Mbi bashkëpunimin ndërkufitar për shkëmbimin e informacionit

- 4.1 Rekomandohet që shërbimet e marrëdhënieve me publikun të vendeve fqinjë në Evropë të zhvillojnë procedura për shkëmbimin e informacioneve publike të lidhura me parandalimin dhe zbulimin e krimit ndërkufitar. Këto marrëveshje për shkëmbim informacioni duhet të përfshijnë dhënien reciproke të informacioneve të publikuara lidhur me krimet ndërkufitare si p.sh kontrabanda, trafiket e paligjshme etj. Ky shkëmbim informacioni duhet të përfshijë edhe dhënien e këtij informacionit, me kërkesë të tyre, gazetarëve, OJF-ve si dhe publikut me qëllim lehtësimin e kërkimeve dhe studimeve rreth krimit ndërkufitar si dhe të ndihmojë në përpjekjet për parandalimin e krimit.
- 4.2 Rekomandohet zhvillimi i procedurave për të mbështetur punën e gazetarëve. Këtu mund të përfshihen sigurimi i kontakteve për gazetarët dhe lehtësimi i punës së tyre duke u krijuar të njëjtat mundësi si dhe gazetarëve vendas. Kjo mbështetje mund të përfshijë sipas rastit, edhe ndihmë materiale për gazetarët që hetojnë një çështje të caktuar, si p.sh mbështetje për marrjen e vizave.

Pranohet që, ashtu siç thuhet edhe në Udhëzimin 4, gazetarët që hetojnë një çështje lidhur me krimin ndërkufitar, ashtu si edhe në hetime të tjera gazetareske, të mund të kërkojnë burime alternative informacioni.

5 KËSHILLA TË RËNDËSISHME SI TË PËRMIRËSOJMË DHE FORCOJMË MARRËDHËNIET POLICI - MEDIA

Shpesh marrëdhënia polici - media mund të përkufizohet si mjaft e tensionuar. Gazetarët, të etur për lajme e ngjarje dhe të presuar nga afatet dhe konkurenca, ankohen se zyrtarët të policisë i pengojnë në marrjen e informacioneve, intervistave dhe pamjeve që do t'i ndihmonin ata në kryerjen me sukses të punës së tyre.

Policët nga ana e tyre ankohen se gazetarët e tepërojnë me zellin e tyre duke shpërqëndruar policinë nga puna dhe në disa raste mund edhe të kompromentojnë hetimet.

Si rezultat i këtyre raporteve policia mund të neglizhojë mundësinë për ta përdorur median në favor të punës së saj.

Më poshtë po radhitim disa këshilla për përmirësimin e marrëdhënieve me median:

1. Të jesh krijues dhe të shfrytëzosh të gjitha mundësitë për një paraqitje pozitive në media.

Në përvojën ndërkombëtare përmenden shembuj si p.sh organizimi i emisioneve

të veçanta ku shfaqen pamje dhe përshkruhet puna e përditshme, e padukshme që punonjësit dhe oficerët e policisë bëjnë duke luftuar dhe parandaluar krimin në të mirë të komunitetit.

Gjithashtu duhen shfrytëzuar të gjitha mënyrat dhe llojet e mediave duke përfshirë radiot, shtypin e përditshëm të shkruar apo dhe elektronik, për të bërë, në një farë mënyre, reklamë punës së policisë. Mundësitë që krijon p.sh interneti janë të panumërta dhe duhen shfrytëzuar në maksimum.

Përpiquni që në bashkëpunim me radiot lokale (dhe sigurisht pas konsultimit dhe me lejen e eprorëve) të ideoni një emision radiofonik të drejtëpërdrejtë ku dëgjuesit të kenë mundësinë të pyesin një oficer apo punonjës policie. Në të njëjtën mënyrë mund të bashkëpunohet me botues të shtypit lokal për krijimin e mundësisë për botimin periodik të një seksioni të veçantë të tipit “Ju pyesni—ne përgjigjemi”



Një tjetër mënyrë për përmirësimin e marrëdhënieve dhe rritjen e bashkëpunimit me mediat do të ishte ideja e “bashkëpatrullimit”. Mund të ftoni gazetarë që të jenë pjesë e patrullave të policisë në një ditë të zakonshme pune. Kjo praktikë do të ketë një rezultat të dyfishtë. Së pari do të ndikojë në njohjen më nga afër dhe miqësimin me gazetarët e zonës tuaj të policimit. Së dyti kjo mund të jetë një metodë efikase në mënyrë që secili, por sidomos gazetarët, të njihen dhe përballen direkt dhe personalisht me sfidat dhe vështirësitë e përditshme që hasin punonjësit e policisë në punën e tyre. Në këtë mënyrë krijohet mundësia që gazetarët të njohin nga afër interesat, motivimin e punonjësve të policisë për t'i mirëkuptuar ata dhe të krijuar një imazh real dhe të drejtë për punën dhe vështirësitë e tyre të përditshme. Krijimi i marrëdhënieve miqësore me gazetarët, le ta themi, mund t'ju shërbejë reciprokisht në një të ardhme.

Në të njëjtën mënyrë, mendoni si do të ishte që ju vetë (si punonjës policie) një nga ditët tuaja të lira ta kaloni me një ekip gazetarësh (televizioni apo edhe medias së shkruar). Kjo mund t'ju duket e çuditshme por do të habiteni nga mundësitë që ju krijon një “aventurë” e tillë për të kuptuar motivimin dhe metodat e punës së gazetarëve.

2. Sigurohuni që media të jetë prezente edhe në rastet kur ju jeni të suksesshëm.

Organizimi i aktiviteteve me karakter social, edukativ (një festë e organizuar me nxënës të një shkolle apo një aktivitet për ngritje fondesh në ndihmë të një familjeje apo komuniteti në nevojë etj) janë një rast i mirë mediatik. Mos përtuni, por bëni përpjekjet maksimale në mënyrë që të bindni sa më shumë media të jenë të pranishme. Nëse zakonisht ju dërgoni njoftime për shtyp për të lajmëruar mediat të marrin pjesë në veprimtari të përditshme të policisë dhe e lini me kaq, përpiquni të vazhdoni më tej duke u telefonuar personalisht

gazetarëve apo botuesve të ndryshëm. Është detyra juaj ta paraqisni sa më mirë dhe ta bëni aktivitetin sa më tërheqës për mediat dhe t'i bindni ata se ja vlen të jenë të pranishëm dhe të realizojnë reportazhe, kronika etj.

3. Krijoni linja të hapura komunikimi

Një linjë e hapur, e përhershme komunikimi mes përfaqësuesve të medias dhe zyrtarëve të policisë mund të luajë një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet polici-media. Gazetarëve, menaxherëve, drejtuesve të mediave duhet t'u krijohet mundësia të komunikojnë lirshëm dhe të ndjehen të pandrojtur për të kontaktuar



me drejtues e zyrtarë të policisë sa herë kanë nevojë. Përveç të tjerash, kjo i lejon policisë të shmangë trajtimin me “keqdashje” nga ana e medias si dhe i krijon mundësinë që ankesat që mund të ketë të mund t'i transmetojë lirshëm dhe të merren në konsideratë nga gazetarët.

4. Pak mirëkuptim për punën e gazetarit nuk do të bënte keq.

Jeta e përditshme e shumicës së gazetarëve nuk është dhe kaq e bukur. Ata punojnë shpesh me orar të zgjatur dhe me paga të ulëta. Ata gjithmonë ndodhen nën presionin e limiteve kohore që duhen zbatuar. Gazetarët përballen me një konkurrencë që në botën e medias është shumë e egër. Ata mund të kenë njëkohësisht disa përgjegjësi ku u lejohet fare pak ose nuk u lejohet asnjë gabim. Ata janë të lodhur. Ata janë të uritur. Dhe mbi gjithë këto ata mendojnë se dikush si ju i pengon në përmbyshjen e detyrës së tyre për të realizuar/shkruar një reportazh/shkrim që për ta mund të jetë një shkallë më tepër në karrierë ose të paktën do të kthehen 1 orë më para në shtëpi. Mendoni pak për këtë.

Kur ju nuk dini ku keni kokën nga punët, ngarjet e shumta, kur jeni duke u marrë me një hetim delikat, një aksident të rëndë apo ndodheni në një moment të vështirë, ju nuk po përjetoni vetëm emocionet e punës; nëse hidhni sytë pas jush, atje do të shikoni një gazetar, reporter, një kameraman. Edhe ata i kanë thërritur dhe ndodhen atje në krye të detyrës në vend që të uleshin në një qoshe duke pirë një kafe apo çaj të ngrohtë.

Kur i mendoni të gjitha këto do ta kuptoni se disa nga vështirësitë dhe sfidat e punës me të cilat përballen gazetarët nuk janë shumë të ndryshme nga ato të punës së policit.

Mos i harroni këto në momentin kur duhet të vendosni nëse duhet t'i shtyni e t'i shani apo t'ju jepni një buzëqeshje mirëkuptimi në një çast të vështirë.

5. Njihuni me nevojat e tyre dhe mundohuni t'ua plotësoni ato

Shmangni sa here të keni mundësi të qenit jobashkëpunues dhe kundër-shtues. Kur keni mundësi, lejoni gazetarët të marrin çdo lloj informacioni që atyre u nevojitet për të realizuar reportazhin/shkrimin e tyre; mënjanohuni dhe krijoni lehësira një fotografi për të bërë një fotografi ose një kameramani për të filmuar pamje. Nëse ju duhet të mos ja plotësoni kërkesat një reporteri/gazetari, mundohuni ta bëni sa më butë dhe njerëzishëm dhe jo me brutalitet. Pak bashkëpunim dhe një ton shoqëror në komunikim do të ishte shumë i dobishëm.

E - Government në Drejtoritë e Vendore të Policisë

“Qeverisje elektronike (e-government) është një mënyrë e organizimit të menaxhimit publik me qëllim ngritjen e efikasitetit, transparencës, aksesimit dhe përgjegjshmërisë ndaj qytetarëve, përmes përdorimit intensiv dhe strategjik të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (ICT) në menaxhimin e brendshëm të sektorit publik si dhe në marrëdhëniet e përditshme me qytetarët dhe përdoruesit e shërbimeve publike.

Funksionimi i e-Governmentit për një organizëm është hapi i parë për zhvillimin e një strategjie. Megjithatë përcaktimet mund të jenë të ndryshme është e rëndësishme të kuptojmë se e-Government është shumë më tepër se sa një website, postë elektronike (email), ose transaksionet nëpërmjet internetit.

Dy janë fushat kyç të cilave duhet t'i referohet e-Governmentit:

1. Sigurimi i shërbimeve:

- ✘ akses publik për të gjithë shërbimet dhe informacionin,
- ✘ në fazat e para do jetë një ndër metodat e tjera tradicionale, më vonë do zgjerohet gama e shërbimeve.

2. Demokracia dixhitale

- ✘ Korespondencë e-mail me zyrtarët e zgjedhur
- ✘ votim nëpërmjet internetit (anketime për të marrë mendimin e qytetarëve për gjendjen e sigurisë).
- ✘ forume qeveritare elektronike,
- ✘ pjesëmarrje në takimet qeveritare nëpërmjet teknologjisë së telekonferencave

PRINCIPET UDHEHEQESE PER E-GOVENMENT:

- 1- BESUESHMERIA- Qeverisja elektronike duhet të sigurojë fshehtësinë (privacy) dhe sigurinë e informacionit dhe transaksioneve duke ruajtur në të njëjtën kohë integritetin e qeverisjes së hapur.
- 2- AKSESIBILITETI- Aksesibiliteti i qeverisjes elektronike duhet të jetë prioritet në mënyrë që gjithë qytetarët të mund të marrin përfitimet e këtij kanali shtesë shërbimesh
- 3- FOKUSIMI QYTETAR- Qeverisja Elektronike duhet të përmirësojë shërbimet ndaj publikut
- 4- PRAKTIKITETI- Sistemi i Qeverisjes Elektronike duhet të zhvillohet bazuar në logjikën e biznesit
- 5- PARTNERITETI- Partneriteti strategjik duhet të inkurajohet dhe krijohet midis qyteteve, shteteve, dhe qeverive për të gjitha iniciativat e e-Governmentit.

SË SHPEJTI NË FAQEN E INTERNETIT TË MINISTRISË SË BRENDSHME

INTERNETI – NJË MUNDËSI MË TEPËR PËR T’U SHFRYTËZUAR

Drejtoritë e Policisë në Qark duke përdorur parime të e-Government-it mund të shfrytëzojnë faqet e tyre të internetit për realizimin e anketimeve me tema të ndryshme.

Qëllimi i një anketimi pilot mund të jetë përcaktimi i ndjeshmërisë dhe opinionit publik përsa i përket cilësisë së shërbimeve që ofron policia në dobi të komunitetit duke shpresuar që rezultatet e një anketimi të tilë të japë një pamje sa më reale nivelit të shërbimeve nga këndvështrimi i publikut si dhe të mundësojë marrjen e sa më shumë sugjerimeve, mendimeve propozimeve etj, për mënyrën se si duhen përmirësuar këto shërbime në të ardhmen. Ky anketim mund të përsëritet në periudha të ndryshme kohore në mënyrë që të bëhet një vlerësim i ecurisë dhe reflektimit të ndryshimeve dhe masave të marra nga policia për përmirësimin e shërbimeve me qëllim plotësimin e nevojave dhe pritshmërisë së komunitetit.

Ky model anketimi është përgatitur nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në kuadër të projekti të mbështetur nga SOROS, për rritjen e rolit të punonjësve të marrëdhënieve me publikun si dhe përmirësimin e marrëdhënieve polici-media-komunitet.

1. A ndjeheni të sigurt në ambientet ku jetoni e punoni?
2. Ju lutemi evidentoni 5 nga problemet e rendit (krimet) që ju shqetësojnë më tepër në zonën, komunitetin ku jetoni.
3. A jeni të kënaqur nga niveli i prezencës / frekuenca e patrullave të policisë
4. A i keni përdorur ndonjëherë numrat e telefonit të policisë për të kërkuar ndihmë apo për të njoftuar policinë për ndonjë problem?
- 4.a Nëse po, a keni mbetur të kënaqur nga përgjigjet apo reagimi i policisë për të ardhur në ndihmë?
5. A jeni të kënaqur nga mënyra e prezantimit dhe e komunikimit të punonjësve të policisë?
6. A besoni se punojësit e policisë i njohin problemet tuaja?
7. Nëse keni nevojë, a mund të kontaktoni lehtësisht me policinë?
8. A jeni në dijeni të aktiviteteve që DPQ organizon në kuadër të zbatimit të filozofisë së policimit në komunitet?
- 8.a Nëse po, a mendoni se këto aktivitete i shërbejnë qëllimit final për përmirësimin cilësor të shërbimeve ndaj komunitetit si dhe rritjen e besimit publik?
9. Komente. Ju lutem shprehni një mendim, qoftë duke përmendur një shembull personal, rreth policies dhe punës së saj.
10. Ju lutem, evidentoni disa nga problemet e rendit që ju shqetësojnë dhe që sipas jush duhet të zgjidhen nga policia sa më shpejt.
11. Çfarë do t’i sugjeronit policisë në mënyrë që shërbimet e ofruara të plotësojnë nevojat tuaja për rend dhe qetësi?

Për ata që bashkëpunojnë me mediat dhe gazetarët

Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve

DEKLARATA E PARIMEVE TË SJELLJES SË GAZETARËVE

Aprovuar nga Kongresi i Dytë Botëror i Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve në Bordeaux më 25-28 Prill 1954 dhe amenduar nga Kongresi i 18-të Botëror në Helsingör më 2-6 Qershor 1986.

Kjo Deklaratë ndërkombëtare shpallet si një standart i sjelles profesionale të gazetarëve të angazhuar në mbledhjen, transmetimin, shpërndarjen dhe komentimin e lajmeve dhe informacioneve si dhe në përshkrimin e ngjarjeve.

1. Respekti për të vërtetën dhe për të drejtën e publikut për ta njohur të vërtetën është detyra kryesore e gazetarit.
2. Në përmbushjen e kësaj detyre gazetari duhet të mbrojë gjithmonë parimin e lirisë së mbledhjes dhe publikimit me ndershmëri të të gjitha lajmeve dhe të drejtës për një koment dhe kritikë të drejtë.
3. Gazetari duhet të raportojë mbështetur vetën në fakte orgjinën e të cilave ai/ajo e njeh. Gazetarit nuk duhet të ndalojë publikimin e informacioneve të rëndësishme ose të falsifikojë dokumenta.
4. Gazetari duhet të përdorë vetëm metoda të drejta për të siguruar lajme, fotografi dhe dokumenta.
5. Gazetari duhet të bëjë të pamundurën të korrigojë një informacion të publikuar i cili rezulton i pasaktë dhe i dëmshëm.
6. Gazetari duhet të respektojë sekretin profesional përsa i përket burimit të informacionit të marrë në mënyrë konfidenciale.
7. Gazetari duhet të jetë i vetëdijshëm për rrezikun e diskriminimit që mund të shkaktohet nga media, dhe duhet të bëjë të pamundurën të shmangë dhe të mos lejojë këtë diskriminim bazuar mes të tjerash në: racë, gjini, orientime seksuale, gjuhë, fe, bindje politike apo të tjera dhe orgjinë kombëtre apo shoqërore.
8. Gazetari duhet të konsiderojë si gabime të rënda profesionale:
 - Falsifikimin
 - Prezantimin me keqdashje të fakteve të rreme
 - shpifjen, ofendimin, denigrimin, akuzimin e pabazuar
 - mitëmarrjen në çdo formë me qëllim publikimin ose fshehjen e një informacioni.
9. Gazetarët e denjë për këtë profesion duhet të besojnë në detyrën e tyre për të respektuar me besnikëri parimet e shpallura më sipër. Brenda kuadrit ligjor të çdo vendi, gazetarët duhet të njohin vetëm autoritetin e kolegëve të tyre për sa u përket çështjeve profesionale, duke përjashtuar çdo lloj ndërhyrjeje nga qeveritë apo të tjerë.

Zyrat e Marrëdhënieve me Publikun në Drejtoritë e Policisë në Qark, falë edhe trainimeve të shumta përfshi edhe një seri trainimesh të organizuara nga IDN mbështetur nga Soros, i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë informimit dhe sensibilizimit të publikut me anë të fletëpalosjeve të ndryshme ose botimit të buletineve me karakter informativ. Përgatitja e këtyre materialeve propagandistike është mbështetur financiarisht kryesisht nga burime të brendshme por, falë bashkëpunimit, shpesh edhe nga bizneset vendase. Nëpërmjet këtyre materialeve është synuar informimi i komunitetit në përgjithësi, rreth strukturave, punës së policisë si dhe sensibilizimi për çështje dhe probleme specifike. Një vëmendje e veçantë në këto fletëpalosje i është kushtuar sensibilizimit të komunitetit për parandalimin e mbjelljes së bimëve narkotike, problem ky me të cilin drejtori të ndryshme si ajo e Vlorës, Fierit apo Shkodrës janë përballur më shumë e më shpesh. Po ashtu janë bërë përpjekje për informimin dhe sensibilizimin e grupmoshave të ndryshme sidomos të rinjtë dhe adoleshentët, apo edhe prindërve të tyre, për dëmet dhe rreziqet e konsumimit apo të shpërndarjes së lëndëve narkotike. Kjo praktikë përfshihet në punën e policisë për parandalimin e krimit. Përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve me informacione dhe këshilla praktike për sezonin turistik ka qenë një tjetër praktikë e zyrave të marrëdhënieve e publikun. Këto fletëpalosje janë përgatitur edhe në gjuhë të huaja duke pasur parasysh rritjen e numrit të turistëve të huaj që vizitojnë vendin tonë.



INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM

Rr. Elbasanit
 P.O.Box 8177
 Tiranë
www.idm-al.org
idm@sanx.net